

## **Statuti i Shoqatës**

### **"KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT"**

#### **Hyrje**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i krijuar në fakt me 19 Dhjetor 1990, është njohur fillimisht me emërtimin "Forumi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut". Në vitin 1992, ai u pranua anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, dhe me këtë rast u emërtua "Komiteti Shqiptar i Helsinkit". Sipas legjislacionit të atëhershëm në fuqi, dokumentacioni përkatës për krijimin dhe lejimin e veprimtarisë së saj u paraqit në Ministrinë e Drejtësisë.

Pavarësisht nga fakti i mësipërm, për të marrë atributet e personit juridik, në vitin 1995 duhej bërë regjistrimi në Gjykatë. Meqënëse ky detyrim ligjor në atë kohë, u ometua të kryhej, mbas miratimit të ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" si dhe të ligjit Nr. 8789 të datës 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" del nevoja e hartimit të statutit të ri dhe të plotë të shoqatës "Komiteti Shqiptar i Helsinkit"

\*       \*  
\*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj.

## **Neni 1**

### **Emërtimi i shoqatës**

Emërtimi i shoqatës do të jetë "Komiteti Shqiptar i Helsinkit"

## **Neni 2**

### **Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së shoqatës**

2.1 Shoqata ka si objekt:

- a) vëzhgimin e gjendjes së të drejtave dhe lirisive themelore të njeriut si dhe zbatimin e parimeve të shteti ligjor, denoncimin e çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht;
- b) kundërshtimin e çdo forme të diskriminimit të personit për shkak të bindjeve politike, besimit fetar, përkatësisë etnike, racës, gjuhës, pozitës shoqërore dhe ekonomike.
- c) sensibilizimin e opinionit publik për mbrojtjen e lirisive dhe të drejtave të ligjshme të shtetasve;
- d) edukimin ligjor të shtetasve si me legjislacionin e brendshëm, edhe me atë ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut;
- e) Vëzhgimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe të komuniteteve të tjera në Shqipëri në përputhje me standartet ndërkombëtare.
- f) T'u japë këshillime ligjore falas shtetasve që pretendojnë se u janë cënuar liritë dhe të drejtat e tyre.
- g) Të ofrojë opinione ligjore dhe ndihmë ligjore falas në raste të ndryshme të shkeljes të të drejtave të njeriut pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatave shqiptare.

- 2.2 Për realizimin sa më të mirë të objektivave të mësipërme, ajo do të zbatojë programe në fushën e të drejtave të shtetasve duke bashkëpunuar në këtë drejtim edhe me organizatat e tjera jofitimprurëse brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në të gjithë veprimtarinë e tij, do të zbatojë normat kushtetuese dhe legjislacionin e vendit si dhe parimet e formuluar në instrumentat ndërkombëtare të njohura përgjithësisht dhe të ratifikuara nga shteti shqiptar.
- 2.4 Kujdes i veçantë do të tregohet në përsosjen e mëtejshme të legjislacionit vendas sidomos të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

### **Neni 3**

#### **Qendra dhe Territori i veprimtarisë**

Qendra e shoqatës është në Tiranë" Rr. Gjin Bue Shpata, Pall 5/1, ap 4, Tirane. Veprimtaria e saj do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarive të shoqatës "Komiteti Shqiptar i Helsinkit" është pa afat.

### **Neni 5**

#### **Kushtet për pranimin dhe largimin e anëtarëve**

- 5.1 Anëtarësia në shoqatën "Komiteti Shqiptar i Helsinkit", është në baza vullnetare.
- 5.2 Personi që kërkon anëtarësimin në këtë shoqatë duhet të pranojë programin dhe statutin e saj, të mos bëjë pjesë në asnjë parti ose organizatë që ndjek qëllime politike dhe as të angazhohet në aktivitetet e tyre.
- 5.3 Kërkesa për t'u pranuar si anëtar i saj shqyrtohet në Mbledhjen e Përgjithshme të KSHH-së dhe miratohet me votim të hapur të shumicës të të gjithë anëtarëve të KSHH-së.
- 5.4 Anëtarësia pushon:

- a) me largimin vullnetar të anëtarit
  - b) Me mungesën e tij të pajustificueshme në tre mbledhje të njëpasnjëshme të Komitetit; Vendimi në këtë rast merret mbas verifikimit paraprak dhe marrjes së kontaktit me anëtarin që ka munguar.
  - c) kur vepron në kundërshtim me qëllimet e organizatës që përcaktohen në statut.
- 5.5 Në rastet e parashikuara në gërmat "b" dhe "c" kërkohet votimi pro i shumicës së anëtarëve të organit vendimmarrës (KSHH).
- 5.6 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka pranë tij 3 – 5 anëtarë nderi. Çdo anëtar i Mbledhjes së Përgjithshme ka të drejtë të propozoj anëtarë nderi. Miratimi bëhet në Mbledhjen e Përgjithshme me votat pro të shumicës të të gjithë anëtarëve të tij.

## **Neni 6**

### **Mostjetërsimi**

E drejta e anëtarësisë në shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohej me anë trashëgimie.

## **Neni 7**

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarit**

- 7.1 Çdo anëtar i KSHH ka të drejtë të diskutojë dhe të shfaqë lirisht mendimet e tij, të kërkojë sqarime për zbatimin e projekteve dhe harxhimin e fondeve, të parashtojë pretendimet për vendimet e shoqatës që bien ndesh me statutin e saj.
- 7.2 Çdo anëtar ka për detyrë të zbatojë me rigorozitet ligjet në fuqi si dhe statutin e shoqatës, të ngrejë probleme që kanë të bëjnë me cënimin e lirive dhe të drejtave të shtetasve, të aktivizohet në përmbushjen e detyrave në zbatim të vendimeve dhe projekteve të këtij Komiteti.
- 7.3 Cdo anëtar ka për detyrë të derdhë një herë në vit kuotën përkatëse, në ditën e caktuar.

## **Neni 8**

### **Organi drejtues, mënyra e formimit dhe kompetencat e tij**

- 8.1 Organi më lartë drejtues i shoqatës është mbledhja e përgjithshme (KSHH) e anëtarëve të saj që përbëhet nga 11 deri në 15 persona. *Asambleja e Përgjithshme zgjedh nga gjiri i*

- saj një drejtues , i cili do të emërtohet "Presidenti i Asamblesë". Ai do të ketë kompetencë të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, pasi të jetë konsultuar me anëtarët dhe Drejtorin/ren Ekzekutiv; të drejtojë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme; si dhe ta përfaqësojë atë në marrëdhënie me të tretë.*
- 8.2 Mbledhja e përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës. Ai, si rregull, mbledhet një herë në gjashtë muaj, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.
- 8.3 **Mbledhja e përgjithshme ka këto kompetenca:**
- a) *vendos pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve;*
  - b) *shqyrton dhe kontrollon çështjet e veprimtarisë së organizatës, përfshirë dhe ato ekonomike e financiare dhe miraton raportet vjetore përkatëse.*
  - c) *Emëron dhe shkarkon Drejtorin ekzekutiv të KShH*
  - ç) *Zgjedh nga gjiri i vet Bordin vendimarrës të organizatës dhe i delegon atij detyra, veç kompetencave që janë përcaktuar në këtë statut.*
  - d) *Miraton ndryshimet në statut.*
  - dh) *Me propozim të drejtorit ekzekutiv miraton dhe ndryshon:*
    - *planet strategjike 3 vjeçare të KShH-së,*
    - *Rregulloren e brendshme të KShH-së*
    - *Strukturën organizative të KShH-së*
    - *Nivelin e pagesave dhe kriteret për pagat e stafit të KShH-së*
- 8.4 KSHH mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
- 8.5 Organi më i lartë vendimarrës (KSHH) zgjedh drejtorin ekzekutiv. Zgjedhja e tij/saj behet me votimin e shumicës së anëtarëve të KSHH-së.

## **Neni 9**

### **Drejtori Ekzekutiv**

Drejtori Ekzekutiv kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Ndjek dhe kontrollon zbatimin e programeve, projekteve dhe vendimeve të marra nga mbledhja e përgjithshme.
- b) Kontrollon zbatimin e programeve dhe projekteve dhe akt-marrëveshjeve me donatorët
- c) Cakton stafin për zbatimin e programeve dhe projekteve duke patur parasysh strukturën e miratuar nga mbledhja e përgjithshme. Në raste të rralla dhe të ngutshme ai mund të bëjë ndryshime në organizimin dhe strukturën e miratuar dhe si pasojë edhe në stafin përkatës, por për këtë duhet të vihet në dijeni në mbledhjen e tij të parë organi më i lartë vendimarrës (KSHH)

- d) Përfaqëson KSHH në marrëdhëniet me jashtë dhe brenda vendit. Në raste të veçanta ai mund të autorizojë për këtë qëllim edhe persona të tjerë, anëtarë të KSHH
- e) Cakton sipas rastit anëtarë të KSHH, të stafit të tij ose aktivistë të KSHH për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme jashtë dhe brenda vendit.

***Neni 10 - Bordi vendimmarrës***  
***(i shfuqizuar)***

**Neni 11**

**Mjetet financiare të shoqatës**

- 11. 1 Burimet financiare dhe materiale të KSHH janë donacionet që akordohen nga subjekte privatë ose publike, vendas ose të huaj si dhe të ardhurat nga veprimtari të ligjshme ekonomike. Ato përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të shoqatës.
- 11.2 Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta me donatorët përcaktohen në marrëveshjet përkatëse.
- 11.3 Personi i ngarkuar me detyrën e financierit i paraqit mbledhjes së përgjithshme bilancin e të ardhurave edhe shpenzimeve.

**Neni 12**

**Ndryshimet në statut**

- 12.1.1 Ndryshimet në statut mund të bëhen vetëm me vendim të mbledhjes së përgjithshme kur votojnë pro shumica e të gjithë anëtarëve të KSHH.
- 12.1.2 Nisma për ndryshime në statut mund të merret nga Drejtori Ekzekutiv ose nga jo më pak se 5 anëtarë të KSHH-së.

**Neni 13**

**Paga ose shpërblimi**

- 13.1 Anëtarët e KSHH si rregull ushtrojnë aktivitetin e tyre pa shpërblim. Ata shpërblehen në rastet kur përmbushin detyra të caktuara në zbatim të programeve ose projekteve të shoqatës.
- 13.2 (pikë e shfuqizuar).
- 13.3 Drejtori Ekzekutiv si dhe stafi i Komitetit për punën e kryer, përfitojnë sipas rastit pagë, shpërblim ose rimbursime.

#### **Neni 14**

##### **Mënyra e shpërndarjes së shoqatës**

- 14.1 Shoqata mund të shpërndahet me inisiativën e saj kur:
  - a) numri i anëtarëve është nën pesë persona;
  - b) qëllimi për të cilin u krijua është përmbushur;
  - c) nuk disponon fonde për vazhdimin e aktivitetit të saj.
- 14.2 Ajo mund të shpërndahet me vendim të Gjykatës në rastet e parashikuara në nenin 44 të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse".
- 14.3 Në rast shpërndarje të shoqatës ajo çregjistrohet dhe pushon veprimtarinë e saj.